



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KABINETI

Rruga "Qemal Stafa"Tiranetel/fax 04229252

Nr. 567

Tiranë, më 03/03/2003

Lënda : Për bashkërendim të punës me Avokaturën e Shtetit.

GJITHË PROKURORIVE NË RRETHE DHE
PROKURORIVE USHTARAKE.

Për dijeni: AVOKATURËS SË SHETIT

TIRANË

Me qëllim bashkërendimin e punës së Organit të Prokurorisë me Avokaturën e Shtetit, në mbështetje të nenit 1, pika 1/a ;2 dhe 5 të ligjit 851 datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit" si dhe të neneve 61 dhe 63 të Kodit të Procedurës Penale, porositen të gjitha Prokuroritë e Rretheve dhe ato Ushtarake, që në rastet kur gjatë proceseve penale konstatohet se palë e dëmtuar materialisht e financiarisht është shteti, të njoftojnë sa më parë me shkresë Avokatin e Përgjithshëm në Avokaturën e Shtetit.

Ky veprim të kryhet me qëllim që të sigurohen kushtet që ky institucion të marrë masat e nevojshme për ngritjen e padisë civile në procesin penal, apo për të bërë kërkesën për sigurimin e padisë civile.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Theodhori



